

Emertimi i shoqerise dhe forma ligjore :	“ TIRANA EAST GATE “ Sh.p.k
NIPT :	K 82231001 H
Adresa e selise :	Rruga Nacionale, Tirane - Elbasan
Telefon :	(4) 2 380 124
Fax :	(4) 2 380 170
Data e themelimit :	21 Tetor 2008
Data e Regjistrimit ne QKR :	31 Tetor 2008
Veprimtaria kryesore :	Aktiviteti i ndertimit, prodhim materialesh ndertimi, ndermjetsim per shitblerje dhe dhenie me qera te pasurive te paluejtshme. Tregeti me shumice e pakice, Import/Eksport mallrash. Servis pajisjesh. Transport mallrash e udhetaresh, sipas objektit te veprimtarise te percaktuar ne Statut dhe aktin e regjistrimit ne QKR.

PASQYRAT FINANCIARE

Periudha kontabël e Pasqrave Financiare :	01.01 .2012 deri 31.12.2012
Data e mbylljes së Pasqrave Financiare :	29.03.2013
Pasqyrat Financiare janë :	INDIVIDUALE
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në :	LEKE
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullaksura në :	

TEG
tirana east gate
NIPT: K82231001H

Permbajtja

Faqe

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

1

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

3

PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE

4

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

5 – 25

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

AKTIVE	Shënime	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Aktive afatgjata			
Prona për investim		-	6,860,530,716
Aktive afatgjata materiale	6	6,864,867,975	390,052
Parapagime për ndërtimin në proces		-	-
Kosto financimi të shtyra		-	-
Total - Aktive afatgjata		6,864,867,975	6,860,920,768
Aktive aftashkurtra			
Aktive tatimore te shtyra	7	17,185,217	4,747,825
Parapagimet		2,904,546	49,776,534
Inventaret		1,392,302	2,333
Të tjera të arkëtueshme	8	73,499,935	127,763,433
Të drejta nga shteti	9	19,497,568	121,671,828
Mjete monetare dhe të ngjashme	10	111,563,271	122,795,235
Te ardhura te llogaritura		4,774,728	6,790,301
Total - Aktive aftashkurtra		230,817,567	433,547,489
TOTAL AKTIVE		7,095,685,542	7,294,468,258
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali			
Kapitali aksionar	12	3,353,338,000	3,353,338,000
Fitimi I akumuluar		(47,509,153)	(15,314,126)
Humbja për periudhën		(112,548,493)	(32,195,027)
Total – Kapitali		3,193,280,354	3,305,828,847
Detyrimet			
Detyrime afatgjata			
Huatë nga institucionet financiare	11	3,104,337,100	3,249,877,693
Llogari te tjera te pagueshme afatgjata		37,481,272	38,251,258
Total - Detyrime afatgjata		3,141,818,372	3,288,128,951
Detyrime afatshkurtra			
Huatë nga institucionet financiare	11	414,136,157	396,368,291
Detyrime tatimore	13	115,158	234,541
Furnitorë dhe të tjera detyrime	14	346,335,501	303,907,629
Total - Detyrime afatshkurtra		760,586,816	700,510,461
Total - Detyrime		3,902,405,188	3,988,639,411
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET		7,095,685,542	7,294,468,258



Këto pasqyra financiare janë autorizuar nga Drejtimi më 29 Mars 2013 dhe nëshkruar në emër të tij nga:

Mariola KUCI

Valbona AGO

Drejtor i përgjithshëm

Drejtor i Departamentit të Financës

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrën financiare nga 1 te 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEG
tirana east gate
 NIPT: KRI, 31001H

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Të ardhura			
Të ardhura te tjera	16	574,030	-
Të ardhura nga Shërbimet	15	882,212,388	136,867,124
Shërbime	17	(186,428,258)	(90,090,389)
Shpenzime operative	18	(132,298,536)	(23,883,463)
Shpenzime për personelin	19	(6,442,609)	(5,288,712)
Amortizimi	6	(308,329,568)	(24,267,013)
Të tjera shpenzime operative	20	(54,259,453)	(7,136,846)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	22	(14,188,504)	8,997,633
Të ardhura / shpenzime financiare, neto	21	<u>(305,825,374)</u>	<u>(30,447,220)</u>
Humbja para tatimit		<u>(124,985,884)</u>	<u>(35,248,886)</u>
Tatimi mbi fitimin	23	<u>12,437,392</u>	<u>3,053,858</u>
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse		<u>-</u>	<u>-</u>
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse		<u>(112,548,493)</u>	<u>(32,195,027)</u>

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 te 25 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

	Kapital i nenshkruar	Kapital i papaguar	Fitim/Humbja akumuluar	Total
31-Dec-09	2,747,430,000	(287,517,692)	(18,981,451)	2,440,930,857
Rritje ne Kapitalin e nenshkruar	-	-	-	-
Kontribut ne Kapital	-	287,517,692	-	287,517,692
Fitim/ (Humbja) e periudhes	-	-	3,667,325	3,667,325
31-Dec-10	2,747,430,000	-	(15,314,126)	2,732,115,874
Rritje ne Kapitalin e nenshkruar	605,908,000	(605,908,000)	-	-
Kontribut ne Kapital	-	605,908,000	-	605,908,000
Fitim/ (Humbja) e periudhes	-	-	(32,195,027)	(32,195,027)
31-Dec-11	3,353,338,000	-	(47,509,153)	3,305,828,847
Rritje ne Kapitalin e nenshkruar	-	-	-	-
Kontribut ne Kapital	-	-	-	-
Fitim/ (Humbja) e periudhes	-	-	(109,201,346)	(109,201,346)
31-Dec-12	3,353,338,000	-	(156,710,499)	3,196,627,501

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 te 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2012	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2011
Aktivitetet operative		
Humbja para tatimit	(124,985,884)	(35,248,886)
Korrigjime mbi humbjen neto për të përfituar flukset monetare nga aktiviteti operativ:		
Shpenzimet amortizimi	308,329,568	24,267,013
Te ardhura nga interesi	(581,045)	(1,182,435)
Efektet nga kurset e kembimit	-	-
Flukset monetare operative përpara lëvizjeve në kapitalin punues	182,762,639	(12,164,308)
(Rritje)/ulje të inventareve	(1,389,969)	-
Rritje në llogaritë e arkëtueshme	158,453,332	101,497,924
Rritje)/ulje në parapagime	46,871,988	(54,339,355)
Rritje kosto financiare e shtyre	-	-
Rritje në furnitorë dhe detyrime të tjera	42,308,489	(102,525,535)
Rritje /(Ulje) në llogaritë të tjera të pagueshme afatgjata	(769,986)	35,464,249
Paraja e përdorur në aktivitetin operativ	428,236,492	(32,067,025)
Interes i arketuar	581,045	1,182,435
Paraja neto nga aktiviteti operativ	428,817,537	(30,884,590)
Aktivitetet investuese		
Pagesat për ndërtime në proçes		(1,785,266,056)
Blerje aktive afatgjata materiale	(312,276,774)	(256,362)
Paraja neto e përdorur në aktivitetin investues	(312,276,774)	(1,785,522,419)
Aktivitetet financuese		
Te hyra nga nenshkrimi i kontratave të huave	176,217,299	1,265,367,890
(Rritje)/ulje në kosto të tjera huaje	(18,090,391)	3,513,213
Interes i pagueshem	(8,744,062)	18,842,335
Likuidim i huave	(277,155,572)	-
Të hyra nga emetimi i kapitalit aksioner	-	605,908,000
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financiare	(127,772,727)	1,893,631,439
Rritja neto në mjete monetare dhe të ngjashme	(11,231,963)	77,224,430
Mjete monetare dhe të ngjashme në fillim të periudhës	122,795,235	45,570,805
Mjete monetare dhe të ngjashme në fund të periudhës	111,563,272	122,795,235

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 te 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Tirana East Gate Sh.p.k. është një Shoqëri e themeluar në 21 tetor 2008 sipas ligjeve të Shqipërisë, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe kryesor Mane TCI me 100% të kapitalit të paguar të Shoqërisë. Vlera e kapitalit fillestar ishte 100,000 Lek. Mane TCI sh.p.k. është një Shoqëri lider në Shqipëri në tregun e zhvillimit dhe investimin në real estate, e cila është pronë e Z. Samir Mane nëpërmjet shoqërisë private BALFIN sh.p.k.

Qëllimi kryesor i Shoqërisë është të investojë në ndërtimin e një qendre të re tregtare, e quajtur Qendra Tregtare Tirana East Gate dhe e lokalizuar në Lundër, Tiranë ("Projekti").

Në qershor 2009 Shoqëria dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) kanë nëshkruar dy marrëveshje huaje për financimin e Projektit. Këto marrëveshje u ndryshuan më pas më 15 mars 2010. Financimi i kostove shtese per perfundimin e projektit u mbulua me nje hua nga aksioneri kryesor prej 211,778 euro.

Në këto marrëveshje është përcaktuar struktura e financimit të Projektit, si më poshtë:

Kapitali	21,000,000 EUR
Huaja kryesore - DEG	10,000,000 EUR
Huaja mezanine -BERZH	7,000,000 EUR
Huaja kryesore - BERZH	10,000,000 EUR
Huaja Ortaku	211,778 EUR
Totali	48,211,778 EUR

Në mënyrë që të arrihet niveli i kërkuar i kapitalit, Mane TCI kërkoi për partnerë të tjere për t'iu bashkuar Projektit. Në gusht 2009 AAEF – Albanian American Enterprise Fund u bashkua si një aksioner me 8.095% të kapitali total aksioner. Gjatë vitit kapitali aksioner u rrit në vlerën 3,353,338 mijë Lek.

Qendra filloi aktivitetin e saj ne Nentor te vitit 2011 dhe viti 2012 eshte viti i pare i plote i operimit te saj si "Qender Tregtare".

Gjate vitit fiskal 2012 administrator i kompanise ka qene Z. Alket Hajdini ndersa nga data 24 Janar 2013 me vendi te asamblese eshte emeruar ne kete pozicion Znj. Mariola Kuci.

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

(a) Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

(c) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria (shiko gjithashtu shënimin 3.a)

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën rishikimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhme, në të cilën ato ndikojnë.

Informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë përfshirë në shënimin 5.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

(e) Standarde dhe Interpretime në publikim ende të pa adoptuara

Një numër standardesh të reja, ndryshime të standardeve dhe interpretimeve të standardeve janë efektive për vitet që fillojnë pas datës 1 janar 2012 (të listuara më poshtë), dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Asnjë nga këto nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Shoqëria nuk planifikon të adoptojë më herët këtë standard dhe shtrirja e ndikimit nuk është përcaktuar:

- SNRF 9 “Instrumentat financiare”(efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2015),
- SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),SNRF 11 “Marrëveshjet e përbashkëta” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- SNRF 12 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për përfshirje me entitete të tjera” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- SNRF 13 “Matja e vlerës së drejtë” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- SNK 27 (rishikuar në 2011) “Pasqyrat financiare individuale” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- SNK 28 (rishikuar në 2011) “Investime në filial dhe shoqeri të përbashkëta” (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNRF 1 “Adoptimi i standardeve ndërkombetare të raportimit financiar për herë të parë”- Hiperinflacioni i rëndë dhe heqja e datave fikse për adoptuesit për herë të parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- Ndryshime në SNRF 7 “Instrumentat financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese”- Transferimi i aktiveve financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2011),
- Ndryshime në SNRF 9 “Instrumentat Financiare” dhe SNRF 7 “Instrumentat Financiare-Shpjegime” – Data e detyrueshme e hyrjes në fuqi dhe paraqitjet e kalimet.
- Ndryshime në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” – Paraqitja e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2012),
- Ndryshime në SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat” – Tatimi i shtyrë: Mbulimi i aktiveve kryesore (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2012),
- Ndryshime në SNK 19 “Përfitimet e punonjësve” – Përmirësime të kontabilizimit për përfitimet pas punësimit të punonjësve (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013),
- Ndryshime në SNK 32 “Instrumentat Financiare: paraqitja” –_Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2014),
- KIRFN 20 “Shpenzimet e nxjerrjes në fazën e prodhimit të një sipërfaqje miniere” – (efektive për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2013).

Drejtimi parashikon që aplikimi i këtyre Standardeve dhe Interpretimeve nuk do të ketë ndonjë ndikim të konsiderueshëm në pasqyrat financiare të saj në periudhën e aplikimit fillestar për shkak të natyrës së limituar të transaksioneve të kryera nga Shoqëria.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

(f) Standardet dhe Interpretimet të aplikueshme në periudhën aktuale.

Ndryshimet që vijojnë të standarteve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar Ndërkombëtar janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet në SNRF 1 “Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë”**- Përfshirje të limituar për informacionin krahasues për SNRF 7 për përdoruesit për herë të parë (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2010),
- **Ndryshime në SNK 24 “Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura”** – Thjeshtimi i kërkesave për dhënie të informacioneve shpjeguese për subjektet e lidhura me qeverinë dhe saktësimi i përkufizimit të një pale të lidhur (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2011),
- **Ndryshime në SNK 32 “Paraqitja e instrumentave financiare”** – Kontabiliteti për çështjet e të drejtave (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 shkurt 2010),
- **Ndryshime në standardet dhe interpretimet e ndryshme “Përmirësimet në SNRF (2010)”** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF të publikuara më 6 maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e fjalëve (ndryshimet duhet të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2010 ose 1 janar 2011 në varësi të standardit / interpretimit),
- **Ndryshime në KIRFN 14 “SNK 19 — Limiti mbi një aktiv me perfitime të percaktuara, kërkesat minimale për financim dhe bashkëveprimi i tyre”** – Parapagimet e kërkesave për një fond minimal (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2011),
- **KIRFN 19 “Detyrimet financiare me shuarjen e instrumentave të kapitalit”** (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 korrik 2001).

Këto ndryshime në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël, pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyre konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën në të cilën ndodhin përveç diferencave nga këmbimi për hua të marra për ndërtimin e aktiveve për tu përdorur në të ardhmen, të cilat janë të përfshira në kostot e këtyre aktiveve në momentin që këto konsiderohen si rregullime të kursit të këmbimit të interesit të këtyre huave.

Instrumentet financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha të drejtat e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur Shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'regjistron një aktiv në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset e të ardhurave skadojnë, ose kur të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave transferohen me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe risqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara, paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat jo derivativë të Shoqërisë përfshijnë të tregëtueshmet dhe llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj, të tregëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme të tjera.

Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet financiare

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektive, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektive.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Instrumentat financiarë (vazhdim)

Të tjera

Instrumentë të tjerë financiarë jo derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës së interesit efektive minus humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

Prona për investime

Prona për investime, të cilat janë pronësi të mbajtura për të fituar të ardhura nga huadhënia dhe/ose për rivlerësimin kapital (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që risqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te Shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, ne vijim investimet në pronësi maten me modelin e koston.

Pronat, të cilat janë në ndërtim ose në zhvillim për shfrytëzim të mëvonshëm si prona për investime, mbahen me kosto, duke zbritur cdo zhvlerësim të njohur. Kostoja përfshin pagesat për shërbimet profesionale dhe, për aktivet e kualifikuara, koston e huamarrjes të cilat kapitalizohen.

Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Koston përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e caktuar, koston e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe koston e kapitalizuara të huave. Koston gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse në lidhje fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisje.

Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale percaktohen duke krahasuar akëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Koston në vijim

Koston për zëvendësimin e një aktivitet regjistrohen me vlerën e kontabël të aktivitet në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndoshin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitet ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20%. Kjo mënyrë pasqyron më përafërsisht trendin e konsumit të benefiteve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Përmirësimet e aktiveve të marra me qera amortizohen mbi 20 vjet. Aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

Aktivitet afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga Shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë vjetore amortizimi 25%.

Rënia në vlerë

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo date raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie të vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e vlerësuar në të ardhmen nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar aktualizuar me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse (në humbje ose fitim). Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të Shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë për rënie në vlerë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontoohen për të arritur në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme.

Një humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitet tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të Shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në momentin e ndodhjes.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, Shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen aktualizimi i flukseve të pritshme me një norme taksës që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe riskut specific të detyrimeve.

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

Pagesat e qerasë

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati që qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundur që të ardhura të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivitetet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një rrezik të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i taksave është i pasigurtë. Shoqëria njih detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktiv dhe pasiv aktual ose të shtyrë në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

5. Menaxhimi i Riskut Financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

- risku i kreditit
- risk i likuiditetit
- risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe menaxhimin e riskut, dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Menaxhimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të riskut të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura të riskut, dhe për të monitoruar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standarteve e procedurave të menaxhimit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentat kryesorë financiarë të Shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet me to, të arkëtueshme dhe të pagueshme, të tjera të pagueshme.

(a) Risku i kreditit

Më 31 dhjetor 2012 Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të kreditit. Viti 2012 është viti i parë i plotë i operimit të qendrës. Specifikisht në 31 dhjetor 2012 shoqëria ka vetëm një çështje për mospërbushje të detyrimeve kontraktore në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Shoqëria gjithashtu ka dhe 2-3 kliente të tjera që deri në 31 dhjetor kanë tejakluar afatet e likuidimit të detyrimeve kontraktore por që pritet të likujdojnë në periudhën e parë të vitit 2013.

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo të ndonjë aktivi tjetër financiar. Qëllimi i Shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në ato të vështira, pa patur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE
Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)

(c) Risku i tregut

Risku i tregut është risku i ndryshimit të cmimit të tregut, të tillë si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe cmimet e kapitalit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumentave financiare të zotëruara prej saj. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshme ndërsa optimizohet e ardhura.

Risku i interesit

Aktivitetet e Shoqërisë mbi të cilat aplikohet interes konsistojnë në llogari rrjedhese në banka, keshtu që të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset monetare operative janë të pavarura nga ndryshimet në tregun e normave të interesit. Me 31 dhjetor 2012 Shoqëria ka detyrime mbi të cilat aplikohet interes. Detyrimet ekzistuese lidhen me hua të marra nga institucione financiare ndërkombetare. Keshtu që shpenzimet e Shoqërisë dhe flukset monetare operative mund të ndikohen nga levizjet e normave të interesit në treg dhe me specifikisht nga normat interbank të Eurozonës të bankave me të mëdha për depozitat në Euro (EURIBOR01)

Risku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit lidhur me luhajtje të mundshme në normat e këmbimit përsa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaja.

Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro ndaj Institucioneve Financiare, gjë që ekspozon Shoqërinë ndaj riskut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon balanca të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to që maturohen në të njëjtën periudhë me pagesën e detyrimeve tregtare.

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e riskut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhajtjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudha afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhajtjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur në Shënimin 24.

**TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. Aktive afatgjata material

Aktivët afatgjata material perbehen si me poshte:

Kosto	Pajisje kompjuterike	Mobileri dhe pajisje	Ndertesa	Toka	Totali
Gjendja më 31 dhjetor 2010	177,667	95,833	-	849,899,273	850,172,773
Shtesa	233,862	22,500	-	-	256,362
Transferime	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2011	411,529	118,333	-	849,899,273	850,429,135
Shtesa	18,227,450	19,009,206	-	0	37,236,657
Transferime	-	(36,376)	6,309,864,174	-	6,309,827,798
Gjendja më 31 dhjetor 2012	18,638,980	19,091,163	6,309,864,174	849,899,273	7,197,493,590
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 31 dhjetor 2010	(38,435)	(25,473)	-	-	(63,909)
Shpenzimi i vitit	(63,051)	(12,851)	-	-	(75,902)
Gjendja më 31 dhjetor 2011	(101,486)	(38,324)	-	-	(139,811)
Shpenzimi i vitit	(3,096,415)	(2,207,084)	(302,956,320)	-	(308,259,820)
Pakesime	-	(34,874)	-	-	(34,874)
Transferime	-	-	(24,191,111)	-	(24,191,111)
Gjendja më 31 dhjetor 2012	(3,197,901)	(2,280,282)	(327,147,431)	-	(332,625,615)
Vlera kontabël neto					
Gjendja më 31 dhjetor 2010	139,232	70,360	-	849,899,273	850,108,864
Gjendja më 31 dhjetor 2011	310,043	80,009	-	849,899,273	850,289,325
Gjendja më 31 dhjetor 2012	15,441,078	16,810,881	-	849,899,273	6,864,867,975

Ne Mars te vitit 2012 ka perfluanduar dhe investimi dhe prona ne investim ne vitin 2012 shfaqet si "Ndertese" te aktivet e shoqerise. Godina eshte kolauduar ne Shkurt te vitit 2012.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. Aktiv tatimor i shtyre

Levizjet bruto ne llogarine e tatimeve te shtyra mbi fitimin jane si me poshte:

	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
Ne fillim te periudhes	-	-
E ardhura (shpenzimi) nga tatimi i shtyre mbi fitimin (Shenimi 20)	17,185,217	4,747,824
Ne fund te vitit	17,185,217	4,747,824

